



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE
SEKTORI I PROKURIMIT

Nr.____ Prot.

Roskovec, më____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Vendosja e semaforit në qendër të Roskovecit"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Riparim
çatie;45261910-6 , Riparim dhe renovim;45453000-7.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 8 331 339 (tetë milion e treqind e tridhjetë e njëmijë e
treqindë e tridhjetë e nëntë) lekë pa tvsh,**

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, KLLFLST shpjegon se për llogaritjen e cmime të preventivit Subjekti BOE:”SELAS shpk &MCE shpk” i është referuar në VKM-në nr.216,datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”i cili unifikon metodologjin e llogaritjesë e të formatit të paraqitjes së preventivave dhe analizave teknike te cmimeve per te lehtësuar veprimarin e subjekteve publike dhe private.(dokumentuar me relacionin nr.5846/2Prot ,datë 18.08.2026.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar në sektorin klasik, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 49 ;në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”nenin11, pika 1, gërma b) dhe neni 55,74,77 i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 331 datë 13.05.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 291, datë 15.5.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik” kreu II pika 2/a .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar;”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjësinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas shtojcës 7 të këtyre dokumenteve.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar ;nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, *Pika 4 të* të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023,2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **3 332 535(tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqindë e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar. si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar..

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarrës te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit:**"Vendosja e semaforit në qendër të Roskovecit"**,pika 3 e nenit 77 të LPP”, i ndryshuar; dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..”, si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.”, si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe nenit neni 41, gërma ”c” të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, (duke përfshirë edhe kështet e maturuara për vitin 2026), duke pasur në vëmendje parashikimet e ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetqeverisjes vendore), për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d). Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

1.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 30% e vlerës së përllëgoaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht: **2 499 401 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e një) lekë pa tvsh**, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet. konkretisht: **8 331 339 (tetë milion e treqind e tridhjetë e një mijë e treqindë e tridhjetë e nëntë) lekë pa tvsh**,

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pika b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publik, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatorëve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar ; dhe në nenin 55, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të

vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet. .

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, i ndryshuar parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a(1,2,3,4,) dhe b(1,2,3,4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- **N.P – 1 A Punime gjurmimi në tokë.**

N.P – 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

N.S- 5 A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ; nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga

organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar,

Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Konkretisht:

Llojet e licensave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

KATEGORI A	Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kerkuar per kategorine respektive
N.P – 1 A Punime gërmimi në tokë	Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet	Gërmim dheu gropa shtyllash e puseta toke e forte sip~1.5m	Niveli A
		Gërmim kanalet e kablllove ne toke e forte me krah me seksion deri 0.75 m2	
		Shtrese rere natyrore t-15 cm, mbulim linje e tubacionit	
		Mbulim kanali me material qe sistemohet lehte S-0.14 m2	
		Transport materiale ndertimi,dheu auto+10 km	

	ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore			
N.P – 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërrhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta,	Heqje pllaka betoni ne trotuare (75x0.4ml)	Niveli A	
		Rivendosje pllaka betoni ne trotuar		
		Pajsje profesionale ne dispocizion, per sigurimin teknik ne rruge auto, gjate punimeve		
		Prishje shtresa asfaltobetoni (7.0x0.4)m per kanalet e tubave plastik		
		Prerje shtrese asfalti, makineri profesionale 2 ane per tuba plastik		
		Shtrese stabilizant t=10 cm		
		Shtrese binderi me zall lavatrice me makineri t=5 cm		
		Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice me makineri t=4 cm		
		Bazamente Betoni C-16/20 per bazamente shtylle e puseta		
		Mbrojtje tuba me beton C-16/20,kalim rruge (15x15x700/cope)		

	natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristika h teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.	
--	---	--

N.S- 5 A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.	Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave.	F.V Shirit plastik me shenimin "kabllo elektrik"	Niveli A	
		F.V Kapak metalik me mentesha 30x30cm kabllo elektrik dhe fo		
		F.V Kapak metalik me mentesha 40x40cm kabllo elektrik dhe fo		
		F.V Llampadar automjete, led 3x200 mm,kuqe/portokalli/jeshile		
		F.V Llampadar automjete, led 3x200 mm,me maske drejtimi , kuqe/portokalli/jeshile		
		F.V Llampadar automjete, led 2x200 mm,me maske kembesori , kuqe/jeshile		
		F.V Llampadar automjete, led 2x200 mm,me maske kembesori , portokalli/portokalli		
		F.V Llampadar tregues kohe per automjete 300mm		
		F.V Llampadar tregues kohe per kembesor 200mm		
		F.V kontrollues trafiku, 220Vac 50Hz,8 grupe (komplet programim)		
		F.V Panel elektrik metalik hermetik 50x80x40cm me dritare "zhaluzi" ne bazament betoni per sistemin e semaforit		
		F.V Shkarkues mbitensioni tre fazor ne panel elektrik kryesor		
		F.V Pajisje energjie i pavarur UPS 220V-3kVA		
		F.V Automat termo-elektromagnetik 4P 380V- 16A		
		F.V Automat 1P+N/10A magnetik termik		
		F.V Sinjalizues tensioni 220V-0.5w,per tre faze		
		F.V Siguresa 230V/1A,2A sipas skemes elektrike		
		F.V Shtylle e galvanizuar, D-114mm,H=3.6m		
		F.V Percjelles elektrik bakri PV-500 10mm2		
		F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 3x1.5 mm2		
		F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 4x1.5 mm2		
		F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 7x1.5 mm2		
		F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 12x1.5 mm2		

		mm2		
		F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 12x0.75 mm2		
		F.V Kabell elektrik bakri FG7OR 450/750V 4x2.5 mm2		
		F.V Tub PVC fleksibel i forte z.d D=50/42mm per kabllo elektrik		
		F.V Elktroda tokezimi i galvanizuar ne te nxehte 5 x5x0.5 L=150		
		F.V Kapikorda me kapuc me vida per percj. Ø4,6		
		F.V Puntalina per percjelles 1.5,2.5		

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera ,të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Librezë pune;
- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të disponojë stafin mësipër, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne LPPI ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “a”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** kerkohet për zbatimin e saktë të punimeve e ndertimit semaforit te rrugës sipas parashikimeve në projektin.
- **inxhinieri elektrik & elektricisti** kerkohet për zbatimin e saktë të punimeve elektrike të semaforit sipas parashikimeve në projektin.

2.3.4.Një punësim mesatar i të paktën 9 **(nëntë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi per periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi minimumi per periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit).*

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e

parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 9 është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.5.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

a.)7 **(shtat)** puntor të thjeshtë

Për punonjësit , ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- punonjësit duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave,
-

b.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier elektrik

1 (një) Elektriçist

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për puntorët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

b.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier elektrik

1 (një) Elektriçist

a) Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
 - diplomë /dëshmi, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
 - stafi i mesipërm duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave,

b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesëmarrës si dhe subjektet mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës, duhet të deklarojnë për stafin e tyre të dhënat si më poshtë:

- Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/çertifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					

2					
etj					

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar specialistet e kualifikuar me sipër.

22.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- **1 (një) shofer ose një manovrator** të pajisur me lejen e drejtimit përkatëse nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme, kontratë individuale pune, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) dhe të figurojnë në listepagesa të pakten për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, **ose** kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listepagesat e operatorit ekonomik ofertues
- a) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për punonjësit automakinist, emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerisë së saj.
- b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në rastin kur punonjësit janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojnë emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerisë së saj.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet Neni 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ;në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar , Neni 39, pika 6, gërma “c”

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar shofer dhe manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për shoferin ose manovratorin që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.7.Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit 2 (dy) muaj

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Neni 39, pika 3. **Ky kriter vendoset me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë shpërndarja e fuqisë puntore dhe e mjeteve me anë të një grafiku punimesh. **

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikat ISO si më poshtë:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara më sipër është vendosur në mbështetje të të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te

Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” indryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikata e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve. ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.9. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Autovinc me kosh	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Vibrator betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamion vetshkarkues	copë	1	Në pronësi ose me qera

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi

të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
 - e. Për mjetet që sipas percaktimeve ligjore të qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi... etj. Operatori ekonomik duhet të deklaroj Formularin Permbledhës të Vetedeklarimit në rubrika përkatëse të dhënave për secilin mjet të kërkuar në shtojcën 8.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
 - Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në mbështetur në VKM-në nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

2.3.10- Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" si dhe përcaktimet e pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të perkthyer , origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Punimet objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË KËTIJ OBJEKTI PROKURIMI JANË PËRCAKTUAR
Subjekti BOE:”SELAS shpk &MCE shpk DHE SHPREHIN QARTE KERKESAT E

AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR CILËSINË E KRYERJES SË PUNIMEVE.SIPAS MATERIALIT BASHKËLIDHUR NE SPE.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor,**nr.84,datë.19.08.2026**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"Vendosja e semaforit në qendër të Roskovecit"**,me fond limit total prej: **8 331 339 (tetë milion e treqind e tridhjetë e njëmijë e treqindë e tridhjetë e nëntë) lekë pa tvsh,lloji i procedures: E hapur e thjeshtuar.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Argumentim:Anëtarët pranuan procesverbali preventivin dhe dokumentacionin teknik të hartuara nga Komisioni i posacëm :KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike) i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr.5846prot,datë 29.07.2026, Preventivi është dorëzuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST ,dhe procesverbalin e komisionit nr.5846/1prot,datë 18.08.2026,dhe shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e kryerjes së punimeve.Konkretisht preventivi është hartuar nga Subjekti BOE:”SELAS shpk &MCE shpk të cilët për llogaritjen e cmime të preventivit janë mbështetur në VKM-në nr.216,datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”i cili unifikon metodologjin e llogaritjes e të formatit të paraqitjes së preventivave dhe analizave teknike te cmimeve per te lehtësuar veprimarin e subjekteve publike dhe private.(dokumentuar me relacionin nr.5846/2prot,datë 18.08.2026.

Preventivi I hartuara nga Subjekti BOE:”SELAS shpk &MCE shpk si mëposhtë për objektin: **"Vendosja e semaforit në qendër të Roskovecit"**

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Me objekt: **"Vendosja e semaforit në qendër të Roskovecit"**

Nr	Nr.	Lloji i punimeve	Njesia	Sasia
----	-----	------------------	--------	-------

Analize				
	A.Punime civile per nyjen e semaforit			
1	An 1 (P)	Heqje pllaka betoni ne trotuare (75x0.4ml)	m2	9.6
2	An 2 (P)	Rivendosje pllaka betoni ne trotuar	m2	9.6
3	An 3 (P)	Pajsje profesionale ne dispocizion, per sigurimin teknik ne rruge auto, gjate punimeve	dite	10
4	2.426/3	Prishje shtresa asfaltobetoni (7.0x0.4)m per kanalet e tubave plastik	m3	1.2
5	An 4 (P)	Prerje shtrese asfalti, makineri profesionale 2 ane per tuba plastik	ml	70
6	3.497/b	Germim dheu gropa shtyllash e puseta toke e forte sip~1.5m	m3	3.8
7	3.46/1	Germim kanalet e kablllove ne toke e forte me krah me seksion deri 0.75 m2	m3	9
8	3.182/b	Shtrese rere natyrore t-15 cm, mbulim linje e tubacionit	m2	18
9	An 5 (P)	Mbulim kanali me material qe sistemohet lehte S-0.14 m2	m3	8.2
10	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10 cm	m2	1.4
11	3.229/1	Shtrese binderi me zall lavatrice me makineri t=5 cm	m2	0.7
12	3.233/1	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice me makineri t=4 cm	m2	0.6
13	2.690	Bazamente Betoni C-16/20 per bazamente shtylle e puseta	m3	3.8
14	2.691	Mbrojtje tuba me beton C-16/20,kalim rruge (15x15x700/cope)	m3	0.8
15	An 6 (P)	F.V Shirit plastik me shenimin "kabllo elektrik"	ml	35
16	An 7 (P)	F.V Kapak metalik me mentesha 30x30cm kabllo elektrik dhe fo	copë	5
17	An 8 (P)	F.V Kapak metalik me mentesha 40x40cm kabllo elektrik dhe fo	copë	1
18	2.37/5b	Transport materiale ndertimi,dheu auto+10 km	m3	8
SHUMA A				
	B. Punime instalore per nyjen me semafore			
1	An 15 (P)	F.V Llampadar automjete, led 3x200 mm,kuqe/portokalli/jeshile	copë	9

2	An 16 (P)	F.V Llampadar automjete, led 3x200 mm,me maske drejtimi , kuqe/portokalli/jeshile	copë	2
3	An 17 (P)	F.V Llampadar automjete, led 2x200 mm,me maske kembesori , kuqe/jeshile	copë	10
4	An 18 (P)	F.V Llampadar automjete, led 2x200 mm,me maske kembesori , portokalli/portokalli	copë	3
5	An 19 (P)	F.V Llampadar tregues kohe per automjete 300mm	copë	5
6	An 20 (P)	F.V Llampadar tregues kohe per kembesor 200mm	copë	8
7	An 21 (P)	F.V kontrollues trafiku, 220Vac 50Hz,8 grupe (komplet programim)	copë	1
8	An 22(P)	F.V Panel elektrik metalik hermetik 50x80x40cm me dritare "zhaluzi" ne bazament betoni per sistemin e semaforit	copë	1
9	An 24 (P)	F.V Shkarkues mbitensioni tre fazor ne panel elektrik kryesor	copë	1
10	An 23 (P)	F.V Pajisje energjie i pavarur UPS 220V-3kVA	copë	6
11	An 25 (P)	F.V Automat termo-elektromagnetik 4P 380V-16A	copë	1
12	An 26 (P)	F.V Automat 1P+N/10A magnetik termik	copë	7
13	An 27 (P)	F.V Sinjalizues tensioni 220V-0.5w,per tre faze	copë	1
14	An 28 (P)	F.V Siguresa 230V/1A,2A sipas skemes elektrike	copë	3
15	An 32 (P)	F.V Shtylle e galvanizuar, D-114mm,H=3.6m	copë	6
16	2.481/5	F.V Percjelles elektrik bakri PV-500 10mm ²	ml	12
17	An 9 (P)	F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 3x1.5mm ²	ml	35
18	An 10 (P)	F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 4x1.5mm ²	ml	130
19	An 11 (P)	F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 7x1.5mm ²	ml	400
20	An 12 (P)	F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 12x1.5mm ²	ml	180
21	An 13 (P)	F.V Kabell elektrik kontrolli Cu 450/750V 12x0.75mm ²	ml	320
22	An 14 (P)	F.V Kabell elektrik bakri FG7OR 450/750V 4x2.5mm ²	ml	210
23	An 29 (P)	F.V Tub PVC fleksibel i forte z.d D=50/42mm per kablllo elektrik	ml	190
24	2.496	F.V Elktroda tokezimi i galvanizuar ne te nxehte 5x5x0.5 L=150	copë	8
25	An 30 (P)	F.V Kapikorda me kapuc me vida per percj. Ø 4,6	copë	6

26	An 31 (P)	F.V Puntalina per percjelles 1.5,2.5	copë	960
		SHUMA B	lekë	
		SHUMA A+B	lekë	
		Fondi rezerve 5%	lekë	
		SHUMA	lekë	
		T.V.SH 20%	lekë	
		Vlera e plote instalime nyje semafori	lekë	

Shenime:

1. Çmimet e punimeve me Nr. analize jane reference nga manuali i miratuar, me VKM Nr. 616, dt 23.04.2023
2. Çmimet e punimeve me Nr. analize **An**, jane reference nga analizat teknike nepermjet e-albania dhe sipas tregut te materialeve dhe punetorise.

Afatet e realizimit të punimeve: GRAFIKU I PUNIMEVE BASHKLIDHUR DST NE SPE

Fillon nga **data e nënshkrimit të kontratës dhe** mbaron deri më **2 (dy) muaj ;** Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT

